



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/97

Datë: 24.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-179 për Transportin Rrugor.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/97

Datë: 24.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 500,000 (pesëqind mijë) euro, për projektin "Renovimi i Stadiumit Adem Jashari në Mitrovicë" me kod 13391, për përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës sportive sipas rekomandimeve të UEFA-së dhe FIFA-së.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod organizativ 207, nën programi 80200, kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/97

Datë: 24.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë Nr. 03/L-109, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Obligohet Dogana e Republikës së Kosovës për zbatimin e vendimit të Ministres së Tregtisë dhe Industrisë me numër protokolli 11520, i datës 18.12.2015 për marrjen e masës në importe për material ndërtimor nga argjila.
2. Vendimi i Ministres së Tregtisë dhe Industrisë nga pika 1. e këtij vendimi për marrjen e masës në importe për material ndërtimor nga argjila, prodhon efekte juridike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë